

**VENDIM**  
**Nr. 617, datë 18.9.2014**

**PËR HEQJEN E MASËS SË PEZULLIMIT TË VEPRIMTARISË PËR  
INSTITUCIONIN PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË, SHKOLLA E LARTË PRIVATE  
“HËNA E PLOTË” (BEDËR)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 45, pika 4, e 63, pika 4, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Heqjen e masës së pezullimit të veprimtarisë për institucionin privat të arsimit të lartë, shkolla e lartë private “Hëna e Plotë” (BEDËR).

2. Shkolla e lartë private “Hëna e Plotë” (BEDËR) të vijojë veprimtarinë akademike, duke respektuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni i arsimit të lartë.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe shkolla e lartë private “Hëna e Plotë” (BEDËR) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**